



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
ZËVENDËSKRYETARI

Nr. 105/11 Prot.

Tiranë, me 17/01/2020

URDHER

Nr. 17, datë 17/01/2020

**Për sigurimin e kushteve të nevojshme për realizimin e funksionit dhe detyrave të  
Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2020**

Në mbështetje të neneve 219/3, 226/1/c dhe 230/2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bazuar në nevojat për mbështetje administrative për vitin 2020 të kërkuar nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me shkresën nr. 17 prot., datë 16.01.2020,

**URDHËROJ:**

1. Për të mbështetur veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) caktohen nëpunësit e Gjykatës së Lartë me detyrat si vijon:

a) për mbështetjen e relatorëve të KED dhe të mbledhjes së tij, për hartimin e akteve nënligjore, si dhe për kryerjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për vendet vakante, caktohen këshilltarët ligjorë si më poshtë:

- Z. Besmir Rrapaj  
- Z. Florjan Kalaja  
- Zj. Laureta Nezaj  
- Z. Saimir Nazifi

b) për mbajtjen e ruajtjen e protokollit, arkivës regjistrave dhe dokumentave të KED, lëvizjen dhe përpunimin e dokumentacionit, mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve, zbardhjen e vendimeve, kryerjen e komunikimeve dhe shpërndarjen e postës, si dhe dokumentimin në tërësi të veprimtarisë së KED, caktohen punonjësit si më poshtë:

- Zj. Redjona Myrtja,  
- Zj. Ermelinda Kadiu  
- Zj. Fabiola Muhameti

- Zj. **Elona Kardhiqi**
- Zj. **Dorina Dule**
- Zj. **Vilma Dokushi**
- Z. **Kastriot Shahinasi**

- c) për hedhjen e përpunimin e vendimeve të KED dhe të dhënave të tjera në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë si dhe dokumentimin e veprimtarisë së KED në këtë faqe, caktohet Z. **Elio Zoto**.
  - d) për mbajtjen e marrëdhënieve me median dhe publikun, caktohet Zj. **Ida Vodica**.
  - e) për mbështetjen financiare të veprimtarisë së KED, caktohet Zj. **Vita Hysenaj**.
2. Nëpunësit e mësipërm, krahas detyrave funksionale, mbështesin veprimtarinë e KED, për aq kohë sa është e nevojshme, nën drejtimin e Kryetarit të KED.
  3. Mbështetja e veprimtarisë së KED për vitin 2020 me mjete financiare sipas kërkesave të ligjit dhe akteve të tjera nënligjore të zbatueshme në lidhje me shpërblimin e punës së përbërjes së KED, shtesat mbi pagë për nëpunësit e Gjykatës së Lartë të ngarkuar për të mbështetur veprimtarinë e KED, shpërblimin e punës së ekspertëve të caktuar nga KED si dhe shpenzimet e tjera të nevojshme për veprimtarinë e këtij institucioni, të realizohet sipas buxhetit të siguruar për Gjykatën e Lartë për vitin 2020, nga fondet e caktuara për mbështetjen e KED.
  4. Ky urdhër t'u komunikohet nëpunësve të Gjykatës së Lartë të sipërpërmendur.
  5. Ngarkohen Kancelari dhe nëpunësit e Gjykatës së Lartë të sipërpërmendur për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 Janar 2020.

ZËVENDËSKRYETARI  
ARDIAN DVORANI

